

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR
PËR FONDET E PERFITUARA DHE SHPENZUARA NGA PARTIA
DEMOKRISTIANE NE VITIN 2009 QE PERFSHIN PERIUDHEN 01.01.2009 –
31.09.2009.**

EDUART KILA
PERSON FIZIK
N.I.P.T.NR.K. 326.262.10.A
LAGJA 5 MAJ. PALLATI 500/2
ELBASAN

Elbasan 4/11/2009

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE
TIRANE

ZONJA DHE ZOTERINJ, ANETAR TE KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Ne zbatim te detyrave te percaktuara ne kontarten e sherbimit Nr.ska, Dt. 18.09.2009 lidhur midis dy paleve dhe te nenshkuara nga: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga une Eduart Myrteza Kila, ekspert kontabel i pavarur, licensuar nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar ne Tirane, me license Nr. 49, Dt 10.02.200, paraqes raportin tim, ne konkluzion te auditimit ligjor te detyrueshem per fondet e perfituara dhe shpenzuara nga Partia Demokratiane ne vitin 2009 qe perfshin periudhen 01.01.2009 – 31.09.2009.

Une kam audituar evidencat parciale qe ja bashkangjis ketij akti, te Partise Demokratiane te cilat perfshijne veprimtarine financiare te periudhes 01.01.2009 – 30.09.2009, ku perfshihen levizjet C.A.SH te arkes e bankes per periudhen e mbyllur ne kete date si dhe informacione te tjera shpjeguese.

Pasqyrat e sipercituara jane pergatitur nga subjekti perkates sipas udhezimeve te drejtuesve te Institucionit. Nuk ka rregullore per politikat financiare qe duhet te ndiqen ne kete institucion.

PERGJEGJESIA E DREJTIMIT PER PASQYRAT E HARTUARA

Drejtimi eshte pergjegjes per pregatitjen e ketyre pasqyrave ne pajtim me dispozitat e raportimit financiar dhe hartimin e zbatimin e rregulloreve perkatese, dhe per kete qellim Drejtimi ka vendosur kontroll te brendshem qe ai ka gjykuar te nevojshem per te bere te mundur hartimin e ketyre pasqyrave te sipercituara ne menyre qe ato te mos permbajne anomali materiale per shkak te mashtrimit ose gabimit.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT

Pergjegjesia ime eshte te shpreh nje opinion mbi evidencat e krijuara, bazuar ne auditimin e kryer. Une kam kryer auditimin ne pajtim me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarde kerkojne qe te veproje ne pajtim me kerkesat e etikes dhe te planifikoj e kryej auditimin per te marre siguri te arsyeshme qe keto evidenca nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshiu kryerjen e procedurave per te siguruar nje evidence te auditimit ne lidhje me shumate dhe informacionet shpjeguese te dhena ne evidencat e krijuara.

Procedurat e zgjedhura jane sipas gjykimit tim dhe perfshijne vlersimin e rreziqeve te anomalise materiale te evidencave te krijuara si per shkak te mashtrimit apo gabimeve materiale. Institucioni nuk ka kontroll te brendshem te aktivitetit financiar, po keshtu nuk ka politika kontabel te detyrueshme per t'u realizuar dhe per kete auditimi i kryer perfshiu tere dokumentacionin e krijuar gjendje ne subjekt.

Sa siper une besoj se evidenca e auditimit qe kam siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tim mbi auditimin e kryer.

OPINIONI

Sipas opinionit tim pasqyrat e hartuara japin realitetin e te ardhurave e shpenzimeve te kryera ne periudhen perkatese, por ato kane mngesi pasi jo ne te tera rastet jane konformitetet me kerkesat e ligjes, keshtu jane bere blerje me dokument jo te formatit te percaktuar, A-4, ose pagat nuk kane te ndalur tatim mbi te ardhurat personale e sigurime shendetesore, shoqerore, nuk ka pagim nga pune-dhenesi te sigurimeve shoqerore, etj.

Keto pasqyra nuk jane te pershtatshme per ndonje qellim tjetër por vetem si evidence per te arritur konkluzion se si jane bere shpenzimet e si jane krijuar te ardhurat ne kete Institucion.

ÇESHTJE TE PERGJITHSHME

Institucioni perkates duhet te hartoje pasqyra financiare sipas standardeve te kerkuara nga Shteti Shqiptar duke percaktuar politika kontabile sipas kerkesave ligjore.

- Shuma e shpenzimeve te kryera ne fushaten zgjedhore Dt. 29.06.2009 eshte e barabarte me vleren ne leke 1.946.975, kjo sipas dokumentave te perpiluara, pavarsisht anes ligjore te paraqitjes se tyre.
 - Shuma e financimeve te te treteve ne adrese te kesaj partie paraqitet
- | | |
|---|--------------|
| 1 – KVOTA ANIPRESING | 500.000 leke |
| 2 – Nard Ndoka M.A.Nr. 00, Dt.1206.2009 | 500.000 leke |

- Shenim: per shumen leke 500.000 te financuar nga KVOTA ANIPRESING nuk ka mandat arketimi e as justifikim pagese, kjo sipas dokumentave te paraqitura e audituara.

Sa me siper bashkangjis nje fotokopje te dokumentave qe gjykoj se jane te nevojshme per Ju.

Sipas kontrates se perpiluar jam i gatshem te paraqitem tek Ju per çdo sqarim.

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
E D U A R T K I L A